



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:051396

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05403564

**PKR.nr.249/2022**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti për Krime të Rënda**, duke vendosur sipas kryetarit të trupit gjykues Naser Maliqi, anëtarët e trupit gjykues Veli Kryeziu dhe Menderez Behluli, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi, në çështjen penale të pandehurit B.B nga Kamenica, për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 421 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), te cilin e mbron sipas autorizimt Av. Shemsedin Pira nga Gjilani, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.75/2021 të datës 24.10.1977 pas mbajtjes e shqyrtimit gjyqësor dhe publik me datën 20.02.2024 në të cilin kanë prezantuar prokurori i shtetit Rasim Maloku, i pandehuri B.B, me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av.Shemsedin Pira nga Gjilani, me datën 20.02.2024 mori dhe shpalli ndërsa me datën 28.02.2023 përpiloi këtë:

## AKTGJYKIM

**Ndaj të pandehurit B.B**, nga babai Sh dhe nëna D, e lindur R i lindur me datën .....në fsh.... Komuna e Kamenicës, tani me vendbanim në Gjilan rr. ....me numer personal identifikues ..... ka të kryer Fakultetin Ekonomik, i martuar baba i katër fëmijëve, i punësuar , i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## ËSHTE FAJTOR

### SEPSE

Me datë 17 mars 2021, në intervalin kohor 16:00 h-16:30h, në objektin e ndërmarrjes "E..." në Gjilan si person zyrtar, inspektor tatimor në ATK regjioni Gjilan, në mënyrë të drejtpërdrejtë ka kërkuar dhe ka pranuar përfitimin në para me qëllim që të mos veprojnë në pajtim me detyrat e tij zyrtare, në atë mënyrë që gjatë inspektimit në ndërmarrjen e të dëmtuarit M.B, kishte konstatuar parregullsi në stoqe të malit,

mirëpo i kishte thënë se rasti mund të mbyllet me 5.000 (pesëmijë) euro, kështu që i dëmtuari e thirr në telefon të pandehurin B, i cili vjen në objektin e ndërmarrjes "E.I" ku takohet në një zyrë me të dëmtuarin, të cilit i kërkon dhe i merr 2.000 (dymijë) euro, me qëllim që të mos i shqiptoj gjobë dhe ti mbyllin vitin fiskal për vitin 2019, mirëpo arrestohet në flagrancë nga Policia e Kosovës-hetuesit e DHKEK në Prishtinë, të cilët ishin duke e monitoruar takimin me masa të fshehta të hetimit.

-me çka ka kryer veprën **marrja e ryshfetit** nga neni 421 paragrafi 1 të KPRK.

-Andaj në bazë të nenit 4,38,39,40, 42,43,62,69,70,71,72 dhe 79 të KPRK-se dhe nenit 364, 449 dhe 462 par.2 te KPPK-se, të pandehurin e lartcekur,

## E GJYKON

**Me dënim me gjobë** në shumën prej **1.000,00 € (njimije euro)**, të cilin dënim i pandehuri obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë dhe **me dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite**, në dënimin e shqiptuar me burg **të pandehurit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 17.03.2021 e deri me 12.07.2021, si dhe koha e kaluar ne arrest shtëpiak prej datës 12.07.2021 e deri me 09.11.2021**, i cili dënim me burg do të ekzekutohet pas kalimit të afatit prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do të caktohet një ditë burgim.

**Te akuzuarit B.B** i ndalohet ushtrimi i funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite pas mbajtjes së dënimit me burg.

**Detyrohet** i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 100 € (njqinde euro), ndërsa në emër të viktimave të krimit shumen prej 50 € (pesëdhjetë) euro si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare.

**I demtuari M.B**, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

## ARSYETIM

Prokuroria Themelore ne Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda, me 23 dhjetor 2022, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.75/21, ndaj të pandehurve A.Q, nga Gjilani, për shkak të veprës penal ndihme ne kryerjen e veprës penale nga neni 421 par. 1 dhe B.B për shkak te veprës penale marrje e ryshfetit nga neni 421 par.1 të KPRK, dhe ka kërkuar qe i njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata Themelore ne Gjilan me date 10.02.2023 me Aktvendim **ka hudhe aktakuzën dhe ka pushuar procedurën ndaj te pandehurit A.Q** per shkak te veprës penale ndihme ne kryerjen e veprës penale nga neni 421 par. 1 te KPRK-se, ndërsa Gjykata e Apelit te Kosovës me date 07.03.2023 ka prur Aktvendim PN.nr.250/2023, me te cilin e ka vertetu Aktvendimin e Gjykatës Themelore ne Gjilan PKR.nr.249/22 te dates 10.02.2023.

Ne seancen gjyqësore te dates 05.01.2024, shqyrtimi gjyqësor ka filluar nga e para, per shkak se anetari i trupit gjykues gjyqtari Aziz Shaqiri ka shkuar ne pension, ndersa ne vend te tije si anetar i trupit gjykues ka qen gjyqtari Menderes Behluli.

I akuzuari B.B ne asnjë faze te procedurës nuk e ka pranuar fajesine për veprën penale e cila i vihet ne barre.

#### **Procedura e provave;**

**Dëshmitari B.Xh**, ka deklaruar se mbetete në tërësi pranë deklaratës së dhënë në Prokurorinë e Ferizajit.

Ne vitin 2020 e deri prill 2022 ka qenë duke punuar në ndërmarrjen E. I në Gjilan, si punëtor i thjeshtë.

E di që pronar i kësaj ndërmarrje ka qenë M.B. Unë aty kam qenë punëtor i thjeshtë, për barjte – shitje , çka ka pas nevojë.

Në arkën e shitores kanë punuar fillimisht vëllezërit e M.Bt, më vonë motra, pastaj do vajza tjera por nuk e di saktë se kush. Unë i kam zëvendësu në arkë nëse nuk kanë qenë ata.

Ka ndodhë që edhe kanë ardhë për kontroll inspektorët tatimor. E di që kanë ardhur sepse me ta e kam numëruar mallin.

Herën e fundit për ispektim ka qenë B.B me nja 2 persona tjerë. Këta kanë ardhur me barazu mallin me stoqe.

Ka marrë pjesë gjatë numërimit të stoqeve të mallit.

Nuk e di se a përputhet malli se neve ispektorët nuk na tregojnë a ka përputhje apo jo, vetëm stokun e mallit e tregojmë ne.

Prezent kanë qenë edhe do punëtor tjerë, sepse shumë janë ndrru punëtort, shumë i largojke.

Kjo ndërmarrje ka pas kontabilist një djalë në atë kohë ja ka harru emrin, por e largoj atë djalin e se di emrin, tash spe di a ka qenë kontabilist por ka punu në arkë.

Ilmi Shalën e njoh, ai ka qenë më herët kontabilistë nja 1 vit para se me ndodhë ky rast , se saktë nuk pe di.

Kur është bërë kontrolli e fundit M.B ka qenë aty.

Unë nuk e kam parë ditëve tjera që ka qenë Bi, por veq atë ditë që është marrë prej Policisë Bi, ka qenë në ndërmarrje.

Kur e kanë marrë policia Bin në ndërmarrje më duket se ka qenë pas orës 12:00.

Ditën kritike unë me disa të tjerë kam qenë duke numëruar mallin për regjistrim dhe aty ka kaluar baci B me M, më duket se kanë hypur në katin e ma nalt. Në katin e epërm ka një zyre dhe kuzhina për punëtor. Nuk e di se sa kanë qëndruar.

Unë kam qenë duke e numëruar mallin, Policia e kanë kapur Bin.

2 polic kanë qenë kur e kanë arestu.

Ka punuar edhe një periudhë pas kësaj ngjarje deri në prill 2022. Aty menjëherë unë se kam kuptu pse e kanë arrestu Bin. Më vonë kam dëgjuar se arrestimi i Bit është bërë për marrja rryshfetit.

M nuk është anku diçka që ka naj presion prej ATK -së, ne nuk e kemi dëgju. Bin atë ditë e ka sjell ne ndermarrjen E.I djali i tij me veturë Mercedes, por edhe tash nuk e njoh. Nuk e di se ku jeton M shtëpinë, e ka në ...

Pas daljes nga burgu të B unë kurr nuk jam parë as me M e as me Bin.

**Dëshmitari I.Sh** ka deklaruar, se ka dhënë një deklaratë te prokurori Rasim Maloku për këtë punë, qëndron pranë asaj deklarata pa ndryshim dhe plotësim.

Unë jam mare në pyetje për rastin e B.Bt.

Unë jam ekonomist dhe si punë sekondare e kam mbajtur edhe E -i.

Pas 10 janarit 2021 inspektorët e ATK kanë qenë në kontroll në verifikim të stokeve. Në momentin e ardhjes të inspektorëve të ATK më ka njoftu M.B, se vin të ATK-se dhe duhesh me ardhë për një kohë të shkurtë. Unë kam shku i kam njoftu punëtorët, ka qëndruar aty pak, sa ka qenë nevoja dhe jam largu. Unë nuk jam punëtor i rregullt por vetëm i kam mbajtur librat e kontabilitetit aty. Unë qysh e di nuk u kry inspektimi i ditës mund të ndodhë se ka zgjatë dy ditë. Nga ky inspektim ka dal se është mungesë e stokeve dhe na kanë udhëzuar inspektorët atë mungesë me deklaruar si të shitur. Atëherë unë e kam udhëzuar punëtorit dhe i ka bo dalje atij malli që ka qenë në mungesë. Malli që ka mungu aty nuk ka qenë i regjistruar si i shitur. Nuk më kujtohet se qfarë vlere të mallit ka mungu, vlere e mallit nuk ka qenë simbolike por më e madhe, nuk e di sa ka qen saktësisht.

Unë nuk e di se a është shqiptuar naj gjobë për këtë rast, por sipas rregullti është dashtë me u shqiptua.

Pas kësaj ngjarje jo nuk kam punu aty.

Unë kam dëgjuar në portale që është arrestuar inspektori B e as që e kam ditë për cilin biznes.

Bi është caktuar nga ATK në Prishtinë për analistë të rriskut edhe atë pas inspektimit, mungeseve të Stokëve.

Analizë e rriskut do të thotë kur ATK qëndrore dyshon për parregullsi në një ndërmarrje. Kur dyshohet se vlere e tatimit është ulët. Nuk më kujtohet se a janë shqiptu gjoba për këtë biznes deri sa kam punu për ta.

Nuk më kujtohet se a më ka njoftu mu pronari se a ka pas parregullsi gjatë inspektimit nga ATK.

Unë nuk jam taku me inspektorin B jashta objektit të Elektro im. E kam thirr me më njoftu për gjendjen në Elektro - in, por ska pas kohë me ardhë.

M nuk më ka thënë mu asgjë për gjoba.

Gjobat mund të regjistrohen si shpenzim por unë nuk kam qenë aty më.

Ne seancen gjyqsore te dates 31.01.2024, e me pajtimin e paleve jan lexuar deklarate te demtuarit-deshmitarit M.B, te dhena ne polici dhe prokurori, per shkak te pamundesise qe I njeiti te sigurohet ne seance gjyqsore, edhe perkunder disa perpjekjeve te gjykates qe I njeiti te sillet ne Gjykate. Policia e Ferizajt e kan njoftu Gjykatën, se M.B ndodhet ne Poloni.

**I demtuari-deshmitari M.B** ne deklaraten e dhene ne polici me date 15.03.2021, ka deklaruar se arsyeja e ardhjes ne polici eshte se zyrtaret e ATK ne vazhdimsi ushtrojn presion ne biznesin e tij, me vizita te rregullta dhe te pa rregullta me qellim qe te vendosin ndeshkime dhe te kerkojn rryshfte. Heren e fundit qe kan qen te biznesi I tij ka qen para nji muaji dhe kan kerkuar stokun e mallit dhe pase pergjigjes se punetoreve, te njejit kan thene se numri duhet te jete ndryshe dhe se gjendja nuk eshte e rregullt. Inspektoret kan thene se ketu ka shkelje te mdhaja, ku per pasoje denimi munde te jete deri ne 30.000 euro, por pasi me ju njihemi e rregullojm ndryshe, ju duhet qe ten a jepni 5.000 euro shperblim dhe e mbyllim kete vit fiscal. Ju ka thene atyre se jan ne problem financiare dhe per momentin nuk po munden me jav dhene parate e kerkuara, por gjate javes po mundohemi me jav ba zgjidhjen, dmth tua japim mjetet me qellim qe kjo qeshtje te perfundoj. Duke qen se ne vazhdimsi eshte ne presion te ketyre njerzve, ka vendosur qe rastin ta paraqes ne polici dhe do te takohem me ata ne kordinim me udhzimet qe mi jepni ju. Njeri prej Inspektorve quhet B, edhe dy tjere kan qen ne biznes por nuk jan perzie ata. Bi nuk eshte vetem I perfshire ne kete rast, por edhe inspektoret me emrat Sh dhe F. A rryshfetin e ka kerkuar perms Bit. Sa here qe ka fole me An, I ka thene qe te flase me Bin.

I demtuari-deshmitari M.B e dhene ne Prokurori, I njeiti ka thene se eshte pronar biznesi ne ndermarrjen "E.I" ne Gjilan. E pranon se kan pase vizita nga inspektoret tatimor lidhur me prejardhjen e mallit. I jan shqiptuar gjoba administrative ne emer te biznesit ne vitin 2017 nji gjobe ne shume prej 7000 euro, e pastaji eshte zbritur ne shume prej 600 euro. Ne vitin 2017 inspektori B.B e ka shqiptu gjoben. Edhe ne vitin 2018 dhe 2019 per vizite ka qen inspektori B.B me dy koleg te tjere, I kan thene se ki parregullsi ne biznes dhe per kete duhet me pagu Shumen prej 3000 euro gjobe, mirpo mujna me mbylle me 2000 euro, keshtu qe ne presence te punetorit B.Xh ia ka dhene 2000 euro. Qdo here per vizite ka qen Bi me dy inspector por Bi ka qen kryesor.

Per here te fundit per kontroll ka qen Bi me dy inspector, njera ka qen femer. Ka qen shkurt, tre jave para se me lajmru rastin ne polici. Nuk ka qen aty kur eshte kryer kontrolli nga inspektoret, pork a qen puntori I tij. Kontabilisti I.Sh ka shku ne ATK dhe kur eshte kthyer, I ka thane se se me 2000 euro mundemi me e mbylle vitin 2019 per te cilin edhe ishte bere kontrolli. Pas nja 5-6 dite Bi ka ardhur dhe e ka njoftu se kontrolli ka dale shume keq, thirre An dhe merru vesh me te, mirpo nuk I ka tregu vleren e mallit qe ka dale mungese. Pas takimit me An e kam thirre Bin I cili me tha se

tash po vi te lokali dhe pas disa minutave ka ardhë bashk me djalin be tij, me Bin kan shku ne zyre e firmes dhe ja ka dhan 2000 euro.

Pastaj ka shtuar se ka pase shume prsion nga B.B I cili ka qen I lidhur me kontabilistin tim I.Sh.

### **Leximi i shkresave;**

Shikohen dy CD me audio dhe videoinqizim të masave të fshehta të dt. 17.03.2021, ku gjykata ka konstatu kete gjendje faktike;

Në video shihet tani i akuzuari B.B duke bisedu me të dëmtuarin M.B në zyrën e këtij të fundit, ku B.B e këshillon lidhur me rastin e firmës së të dëmtuarit dhe i dëmtuari M.B i thot B.Bt “a mshilet kjo me 2000 mijë euro”, pastaj M.B i thot Bit “2019 a mshilet “ndërsa Bi përgjigjet po 2019 mshilet me letra”. Pastaj M.B thotë se unë i kam thon Ilmisë

ti jap 5 e le te kryhet. Pastaj B.B i thot Mt se 2020 ti je edhe ma keq. M pastaj thot se për vitin 2019 ka thon 2 mijë, ndërsa B.B i përgjigjet po. Bi i thot shtirë eshte, por veq met nimu e kam. Pastaj shihet B.B duke i marr një sasi të parave nga M.B, ku M i thot njehi pash një zot a ti dhash 2 mijë. M e pyt Bin a jan taman. Pasi që Bi i numronte paratë e marrura dhe ky i fundit i përgjigjet taman. Bi paratë e numruara i fut në xhepin e majtë të pantollave. Bi i premtton Mt, që nesra kom me shti I mi kontrollu . Pastaj në një fazë të bisedës M e pyt B in “allahile kush ma ka caktu këtë shumë” ndërsa Bi i përgjigjet nuk kishe mujt me kalu me qit shumë. Biseda në mes të Mt dhe Bit përfundon me falënderimin e Mt për Bin. Pastaj Bi del nga zyra në lokalin tjetër per shitjen e mallit në përcjellje të M.Bt. Pastaj shihet momenti kur është ndal nga Policia B.B, ku zyrtarët policor kanë qenë pa uniforma dhe janë hy bashkë me Bin në një zyrë, ku pastaj i kanë than që të nxjerr gjithcka nga xhepi , pastaj Bi nga xhepi i pantollova ka nxjerr shumën e parave, e ka vendos në një tavolinë, kuletën, telefonin, qelsat. Pastaj shihet momenti kur zyrtarët policor bëjnë fotografimin e kartëmonedheva që janë gjetur te Bi.

I pyetur i akuzuari B.B se a ke diqka për të shtuar pas shqyrtimit të kësaj video i njëjti deklaron, se nuk e pranoj fajësinë për veprën penale e cila më vihet në barë dhe nuk kam asgjë për të shtuar.

-transkriptet e bisedave të monitoruara me masa të fshehta të dt. 17.03.2021,- nr.DHKEK/74/21 dt.16.03.2021, ku ne nji moment tani i akuzuari B.B thot “problem per 2019. Diskutojn tani i akuzuari B.B me ankuesin M.B, ku Bi i tregon Mt per gjendjen e tije ne biznes, se nuk ka dale ne rregull, qe ka pase shume ma shume shitje. Ankuesi ia ban “po qysh me mshele qita o B, ti e din vjet qysh e kemi mshel, po qysh me e mshel 2019 kallxom ti mu”. Ankuesi i thote Bit “qeto 5.000 veq per 2019, 5 mije jan shume me mshele”. Ankuesi “me ja dhane juve 5 qysh mtha E, dmth ma 2019 sum vjen ma kerkush”. Bi “mu qel qelen po letrat qele nune i msheli”. B.B “ ngom mu per 2019 kryej, per 2020 leje ato tremije tjera, jepi veq dy mije per 2019. Ankuesi “edhe pse une deshta, une i thash E, spi him dy here thsh une po jav jape 5 edhe let kryhet, a pe

din. Bi" po nuk e di puna shka del me 2020, une menoj qe edhe 2020 je edhe ma keq". Ankuesi " jo bre B, jo bre qarti (momenti kur ankuesi i nxjerre parate nga xhepi). Bi " shtir, une veq me te nimu se une e di se me pas kan tjetërkush e kish mshele moti, e kish qu ne Prishtine, tu kish dasht mi dhane gati 20.000 euro. Ankuesi " qe qito, A te merre a shka, allahile njehi mire pashe ni zot" Bi numron parate. Ankuesi "a jane taman". Ankuesi; "a jan taman", Bi; " taman jan".

Ankuesi " kush ma caktoi qet shume A a F". Bi; :nuk kish mujte me kalu me keto 2.000". B.B; " jo une sisha lshu ti ner 5000 hiq, iu kam thane seshte ky njeri per per me, kur dihet se so faji tina" (fjalja deri diku jo e ndertume me kuptim, por ashtu eshte bere transkripti).

-dy vërtetime për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve nga i pandehuri B.B, të dt. 17.03.2021, sipas te cilit nga B.B jan sekuestruar 1x200 euro, 17x100 euro dhe 2x50 euro.

-vërtetimi për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve nga i pandehuri A.Q i dt. 17.03.2021, (ka perfundu lenda per A.Qn).

-procesverbali mbi kontrollin e shtëpive dhe lokalit të të pandehurëve të dt.17.03.2021, ku te B.B nuk eshte gjetur diçka e dyshimtë.

-raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes nga forenzika rajonale me fotoalbum të dt.17.03.2021, përshkruhet mënyra e arrestimit ne flagrance te te dyshuarit B.B, paratë qe i ka nxjerre nga xhepi, te cilat jan numëruar, e qe ka rezultuar te jene ne shume prej 2.000 euro. Jan fotografuar parate.

Ne fotoalbum shifen kartëmonedha ne shuma te ndryshme prej 200,100,50 euro te cilat i jan gjetur te dyshuarit ne gjep.

-autorizimi i përgjithshëm mbi ushtrimin e aktiviteteve zyrtare nga Drejtori Rajonal në Gjilan,

-raportet për vizitat përmbushëse i dt. 19.02.2021 te kryer nga inspektoret tatimor.

-raporti për gjendjen e stoqeve në E i dt. 27.01.2021, ku eshte konstatuar mungese e mallit.

## **MBROJTJA E TË AKUZUARIT**

**I akuzuari B.B** ka thënë, se unë asnjëherë M.Bn nuk e kam thirr në telefon. Gjatë javës së fundit para se mu arrestua, ai më ka thirr tanë javën, unë e kam qel telefonin sepse nuk e kam ditë se kush është. Ditën e fundit kam qenë duke i përcjell disa miq sepse kam pas rast të vdekjes dhe e kam qel telefonin. I thash se kom rast vdekje dhe po më pengon. Të nersmen kur më ka thirr unë më hini një bindje se ky ka një qëllim ndaj meje. M më tha a po vjen te lokali im në Gjilan se nesra unë shkoj në Gjermani. I thash djalit tim a po më afron deri te E, kemi shku me djalin me kerr. Një i afërm i jon ka qenë tu punu te M dhe djali u taku me te, u ndal ndërsa unë jam taku me M në lokal. | Biseduam diçka për çështje familjare e pastaj M më tha se kam bisedu me An për

lëndën të cilën unë e kisha krye që në janar 2021. Pasandaj më propozoj me shkua nalt në zyre dhe më tha po solidarizona me këtë rast që e ki pas me vdekjen, ma von me mi kry djali juv do punë me pllaka dhe nëse nuk mundet djali me mi krye pllakat, unë po ti jap 2000 euro dhe ti mi kthen. Kur kam hy në zyrë ma ka ofrua një kafe me pi, unë pranova dhe ai ka fillu me bisedu rreth kontrollit -verifikimit që e kisha bë unë i thash kjo punë është mbyll. Është e vërtetë që gjatë kontrollit që e kishim ba në biznesin E dhe i kemi shqiptu gjoba. Pas kontrollit kemi konstatuar se tatim paguesi E ka pas mall në stoqe pa origjinë në vlerë afërsisht 1000 euro, mungesë në stoqe afërsisht 34 mijë euro, sipas neve tatimpaguesi nuk i ka mbajt evidencat në mënyrë të drejtë. Në pikën shitëse nr.2 nuk posedonte fare ark fiskale. Këto parregullsi i kemi paraqitur në raportin dhe e kemi paraqit te zyra për gjoba dhe ndëshkime që të veproji sipas ligjit. Sa jam i njoftum kjo zyrë i ka shqiptu gjoba .Unë nuk kam mujt ma kurfar ndihme me i ba lidhur me këtë rast sepse procedura ishte mbyllur ma herët siç e precizova. Pasi e kam pi kafen te M ma nuk jam kon vetvetja, vetëm kur e kam pa veten në paraburgim. Gjatë kohës që isha duke pi kafen M.B mi ka dhanë 2000 euro duke më thënë se po solidarizona për shkak të rastit të vdekjes për kunatën. Unë i thash si ta krym punën e të pamës djali i shtron pllakat dhe ta kthen borxhin, ma shumë a ma pak i llogarisim. Unë i mora paret dhe i kam shti në xhep, ka pas kartëmonedha ka 50 ka 100 por si kam njeh paret. Unë nuk kam pas informacion se M është në vështërsi financiare.

Deklaratat që i ndëgjum të M.Bt janë krejtësisht të pabaza dhe janë të trilluara.

Në nuk e kam mendu se është konflikt interesi, për arsye se procedurën lidhur me kontrollin që e kishim ma herët ishte përfunduar.

Kur më kanë ndal policia, porsa kam dal prej Mt mi kanë gjetur paret në xhep, i kam nxjerr dhe kanë thënë në rregull kokan, nuk e di se sa jan kan, por ma vonë kam marr vesh se fjala është për 2000 euro. Nuk e kontestoj bisedën që e kam ba me M ditën kritike.

Prokurori i shtetit e ballafaqon të akuzuarin me transkriptin e bisedës të zhvilluar ditën kritike në mes të B.Bt dhe M.B ku në faqen e 11 të transkriptit, ndër të tjerash është bisedu B.B ka thënë : ngom mu, 2019-tën kryhet, për 2020 lej ato 3 mijë tjera, jepi veq 2 mijë për 2019.

I akuzuari përgjigjet, mu nuk me kujtohet që i kam fol këto fjalë, është e mundur që M.B të ketë pas ndonjë obligim për këto vite, nuk më kujtohet.  
Nuk më ka shku menja qe munet mem inqizu dikush dhe mem mashtru.

Ne seancen e fundit gjyqësore me propozimin e prokurorit te shtetit Rasim maloku gjykata ka shiquar dy CD, edhe pse ne një seance te mëparshme gjykata i kishte konsideruar si te shikuara, është konstatuar gjendja faktike sikurse ne faqen e 6-te te ketije aktgjykimi.



Pastaj eshte pyetur i akuzuari përsëri se a ka te shtoi diçka ne mbrojtjen e tije, i njëjti ka mbetur ne tersi pranë mbrojtjes se tije te dhëne ne seancën gjyqësore te dates 31.01.2024.

### **Fjala përfundimtare e palëve;**

**Prokurori i shtetit Rasim Maloku** fjalën përfundimtare e ka paraqitur ne forme të shkruar, në të cilën ka thënë se mbetet pranë aktakuzës ndaj te pandehurit B Beunjaku, sepse me provat e administruara nga Gjykata, është vërtetu se i njëjti e ka kryer ketë vepër penale. Kjo u vertetu nga deklarat e dëshmitarit M.B, nga shikimi i dy cedeve me audio dhe video incizim, ku shifet i pandehuri duke i marrë nga i dëmtuari 2000 euro për me mshel vitin 2019, pastaj transkriptuat telefonike ku bisedohet për me e mbylle vitin 2019. Nga përmbajtja e transkriptove vërtetohet se i pandehuri për te mos i shqiptuar gjobe kërkon shpërblim nga i dëmtuari, me ç'rast i merrë 2000 euro të cilat i konfiskon policia.

Pastaj një gjë te tille e vërteton edhe vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve nga B.B i datës 17.03.2021, ku vërtetohet se nga i pandehuri jan konfiskuar 2000 euro, një kartëmonedhë 200 euro, 17 kartëmonedha prej 100 euro si dhe dy kartëmonedha prej nga 50 euro.

Këto fakte vërtetohen edhe nga procesverbali i këqyrjes në vendin e ngjarjes. Konsiderojmë se nga provat e administruara eshte vërtetu se i pandehuri e ka kryer ketë vepër penale.

Përveq fjalës përfundimtare, prokurori i shtetit Rasim Maloku, ka paraqitur edhe një parashtrësë, ku ka përmirsu dispozitivin e aktakuzës, duke e hequr nga i njëjti ish të pandehurin A.Q, për te cilin është hudhur akuza.

**Mbrojtshi I te akuzuarit, Av. Shemsedin Pira** gjithashtu fjalën përfundimtare e ka paraqitur me shkrim, ku fillimisht ka thënë se kemi pase një gjykim të drejtë.

Pastaj I njëjti deklaroi se në aktakuzë nuk jan paraqitur arsyet pse është ngritur e njëjta, duke e konsideruar të pa bazuar dhe të pa qëndrueshme.

Provat e administruara nuk e provojne të jetë kryer vepra penale marrje e ryshfetit siq pretendon akuza. Është e vërtet se M.B ditën kritike e kishte thirrë në telefon Bin, e pastaj ky kishte shkuar tek Lokali "E.I". M I ka propozuar që të shkojn në zyren e tije dhe pasi ka shku Bi, M I ka thënë se po solidarizohem me me ketë rast që ka ndodhur vdekja e familjarit të të pandehurit B, I ka propozu që djali juaj duhet mi kryej disa punë në shtrimin e pllakave, pra une po ti jap 2000 euro, nese nuk mundet me krye ketë punë mi kthen ketë shumë monetare.

Provat te cilat jan siguruar gjate fazës se hetimeve nuk jan siguruar konforme dispozitave ligjore dhe si të tilla nuk mundë te sherbejne si prova, ashtu që nuk mundë të vërtetohet përgjegjësia penale e tani të pandehurit B.B.

Nuk ka asnjë kuptim nëse I pandehuri ka shku për të marrë ryshfet në "E.I" ta merrë edhe djalin e tije me vehte. Deklaratës së të pandehurit duhet ti kushtohet vemendje nga gjykat.

Ndërsa deklarata e dëshmitarit M.B në Polici dhe Prokurori nuk duhet të merret parasysh.

Ka kërkuar që në mungesë të provave I pandehuri të lirohet nga përgjegjsia.

**I akuzuari B.B** ka deklaruar se e përkrahe fjalën perfundimtare të mbrojtjes së tij, ka kërkuar që të lirohet nga përgjegjsia.

**Gjykata ka analizuar provat e administruara dhe mbrojtjen** e të akuzuarit B.B, ka ardhë në përfundim se I njëjti e ka kryer veprën penale marrje ryshfeti nga neni 421 par.1 të KPRK-se.

I dëmtuari M.B I ndëgjuar edhe në cilsinë e deshmitarit në polici, ka thënë në mënyrë shprehimore se B.B I shoqruar edhe me disa inspektor të ATK-se ka qen për kontroll në biznesin e tij E.I" në Gjirokastrë dhe kan konstatu parregullsi- mungese të mallit, për të cilën inspektorët I kan thënë se duhet të paguaj një gjobë prej 30.000 euro, por nëse mirren vesh duhet të paguaj 2000 euro.

Në ditën kritike inspektorët B.B-tani I akuzuar ka shku në lokalitë e "E.I", është taku me M.Bn pronar I biznesit-tani I dëmtuar, kan shku në zyrën e tij dhe aty tani I akuzuari B I ka thënë Mt se për me e mbyllë rastin për vitin 2019 duhet 2000 euro. Pas një bisede ndërmjet veti, M.B ia ka dhënë Bit 2000 euro, ku Bi I ka numruar dhe I ka futë në gjepin e pantollonave, M I ka thënë Bit njëhi a jan mire, Bi ia ka kthyer mire mire, pastaj kan dale nga zyra e Mt, ndërsa hetuesit policor e ndalin, ja gjejn parat e marrura dhe ja sekuestrojn. Këtë deshmitari gjykata ia fale besimin, sepse perputhet edhe me prova te tjera te cilat do ti elaborojm ne vijim.

Video-incizimi, ku shifet B.B duke I marre paratë në shumë prej 2000 euro nga M.B, për me e mbyllë vitin 2019 për "E.I", pastaj me të dale jasht hetuesit policer e ndalin Bin, e urdhrojn që të nxjerrë të gjitha sendet nga gjepat e pantollonave dhe të palltës, ndër të tjera Bi nga gjepat e pantollonave nxjerre edhe shumen e parave që I ka marre nga M, I vendos në një tavilonë, ku shifet se ka pase monedha të ndryshme.

Një gjë e tillë vërtetohet edhe nga transkriptat e bisedave të M.B me të akuzuarin B, ku flitet për rastin në fjalë, duke theksuar se për me mbyllë vitin 2019 duhet 2000 euro, e pastaj konstatohet se të njëjtat jan dhene nga M.B, B.Bt.

Sipas vërtetimit mbi sekuestrimin e sendeve I lëshuar ditën kritike nga ana e policiës, vërtetohet se nga B.B jan sekuestruar 2000 euro, 1x200 euro, 17x100 dhe 2x50 euro.

Gjithashtu paratë e sekuestruara jan fotografuar, ku shëfen kartmonedhat e sekuestruara.

Këtë fakt e pranon edhe vet I akuzuari B.B, se nga tani I dëmtuari ka marrë 2000 euro, sipas tij në shenjë solidariteti, sepse e ka pase një rast vdekje ato ditë, I kishte vdekur gruaja e vllau për të cilën kishin pasë shumë shpenzime për shërim. Pastaj I akuzuari ka thene se paratë I ka marrë nga M, sepse djali I tijë (Bit) ka pasë me ja shtru pllakat Mt.

Fakti I dhënjes solidarë dhe fakti se djali I të akuzuarit ka pase me ja shtru disa pllaka te M nuk eshte vërtetu në asnjë mënyrë. Ne CD-te e shikuara, por as ne transkriptat te bisedave, as që jan permendur këto fakte.

Për këto arsye gjykata është e bindur se B.B e ka kryer veprën penale marrje ryshfeti nga neni 421 par.1 te KPRK-se.

Gjatë matjes dhe shqiptimit të denimit, gjykata ka pase parasysh si rrethanë lehtësuese faktin se është njeri familjar, ka katër fëmijë, ndërsa si rrethana rënduese shkallën e pergjegjesisë, faktin se keto vepra paraqesin shkallë të lartë të rrezikshmërisë shoqrore, rrezikojn funksionimin e shtetit të Kosovës, faktin se edhe përkunder asajë se është simulu vepra penale e korrupsionit ne mnzre krejt ligjore, I njeiti nuk e ka pranu vepren penale qe I vihet ne barre, fakti se është keqepedorim I pushtetit ose pozitës zyrtare nga personi I denuar dhe shkallen e larte të dashjes.

Per kete arsye i akuzuari B.B është gjykuar me denim me gjobë në lartësi prej 1000 euro si dhe me denim me burg në kohezgjatje prej 2 viteve, në të cilën do ti llogaritet masa e paraburgimit prej 17.03.2021 e deri me 12.07.2021 dhe arresti shtepiak prej 12.07.2021 e deri me 09.11.2021.

Gjykata konsideron se keto denime do të ndokojn te I akuzuari që në të ardhmen të ketë kujdes mos ta përsërisë veprën penale dhe të ndokoi te rrethi I tij shoqrorë në mënyre poyitive.

**Te akuzuarit B.B** i ndalohet ushtrimi i funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite pas mbajtjes se dënimit me burg, sepse i njëjti është denuar edhe me burgim prej 2 viteve, por edhe vepra ka lidhje me detyren zyrtare.

I akuzuari është detyruar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 100 € (njqinde euro), ndërsa ne emër te viktimave të krimit shumen prej 50 € (pesëdhjetë) euro si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare.

I demtuari M.B për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
**Më datën 28.02.2023**

**S. Juridike;**  
Kadrije Zymberi

**Kryetari i trupit gjykues**  
Naser Maliqi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, palët e pakënaqura munden te ushtrojnë ankesë ne afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ne Gjykatën e Apelit te Kosovës ne Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.

Numri i lëndës: 2021:051396  
Datë: 04.03.2024  
Numri i dokumentit: 05403564